

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Dega në Kaçanik, departamenti i përgjithshëm në përbërje të trupit gjykues Riza Livoreka kryetar i trupit gjykues, Kadri Rexha e Ibrahim Raka, anëtarë të trupit gjykues, me sekretarën juridike Azemine Berisha, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e [REDAKTUAR], të cilën me autorizim e përfaqson [REDAKTUAR], kundër të paditurës [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], lidhur me çështjen kontestuese besimi i fëmijëve, në shqyrtimin gjyqësorë të mbajtur më dt.14.11.2017 morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I. **MIRATOHET**, në tërsi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] dhe të miturat : [REDAKTUAR], e lindur më datën [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] e lindur me datën [REDAKTUAR] në Prishtinë i **BESOHET** në ruajtje, edukim dhe shkollim Babait të tyre [REDAKTUAR] me vendbanim në Rr "[REDAKTUAR]" në fshatin [REDAKTUAR]

II. Kontakti në mes të paditurës-nënës [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] dhe të miturave [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] mbetet i lire.

III. Ky aktgjykim është i formës së prerë që nga dt.14.11.2017

IV. Secila palë i përballon shpenzimet e krijuara.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tijë si në padi, ashtu edhe në shqyrtimet e mbajtura gjyqësore ka deklaruar se mbetet në tërësi si në thënjet në padi dhe ka kërkuar na Gjykata që kërkesëpadia të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe fëmijët e lindur jashtë martese, të miturat [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] i ti besohet në ruajtje, edukim dhe shkollim babait të tyre.

I autorizuari po ashtu ka deklaruar se këtë kërkesë e parshtrajmë sepse e paditura nuk ka kushte që të kujdesiet për të miturat, andaj nga këto baza i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadin e paditësit ta miratoj në tërsi si të bazuar.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

E paditura në seancën gjyqësore ka deklaruar se nuk e konteston kërkesë padinë e paditësit dhe i ka propozuar gjykatës që të miturat [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] ti besohen në ruajtje

dhe edukim babait të tyre për arsye se nuk është në gjendje ekonomike që të kujdeset për ta, pastaj nuk ka kushte ku të banojnë sepse me të njëjtat jeton tek prindërit ndërsa nevojat e tyre janë duke u rritur.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Gjykata për ta vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje juridike civile me propozimin e palëve ndërgjyqëse e zhvilloi procedurën e provave duke e bërë leximin e këtyre provave të shkruara: u lexua çertifikata e lindjes me nr. serik L0000620496, Çertifikata e shtetësisë, Çertifikata e lindjes për të miturat, eksstrakti i lindjes dhe çertifikata e vendçbanimit për paditësin, pa pyetje pa vërejtje.

Pas analizimit të provave në tërësi dhe të secilës veq e veq si dhe konform nenit 8 të LPK-së dhe bindjes së lirë të gjykatës, gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

Paditësi me të paditurën kanë jetuar në bashkësi jashtëmartesore, qe 8 vite gjatë kohës sa kanë jetuar në bashkësi jashtë martesore kanë lindur 2 fëmijë edhe ate të gjinisë femërore: ■■■■■a ■■■■■e lindur më datën ■■■■■ në ■■■■■ dhe ■■■■■ e lindur me dt. 02.06.2012, dhe pas një kohe raportet e tyre janë çrregulluar dhe të njëjtit nuk jetojnë bashk, ndërsa deri më tani fëmijët kanë jetuar me nënën e tyre.

Se paditësi me të paditurën kanë jetuar në bashkësi jashtë martesore, gjykata këtë fakt e vërtetoi nga deklarata e palëve ndërgjyqëse, të ciltë në seancën gjyqësore deklaruan se një kohë kanë jetuar në bashkësi jashtë martesore.

Se gjatë kohës sa kanë jetuar në bashkësi jashtë martesore kanë lindur 2 fëmijë, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga deklaratat e palëve ndërgjyqëse si dhe nga çertifikatat e lindjes për të mitura ■■■■■ dhe ■■■■■ nga të cilat çertifikata vërtetohet se prind të të miturave janë tani palët ndërgjyqëse.

Se raportet ndërmjet bashkëshortëve jashtë martesor janë çrregulluar dhe përcjellur me probleme ndërmjet tyre dhe se tani të njëjtit jetojnë ndaras këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga deklarata e palëve ndërgjyqëse të ciltë kanë deklaruar se raportet në mes tyre janë keqësuar dhe tani jetojnë të ndarë.

Gjykata pas analizimit të theksimeve të palëve ndërgjyqëse kërkesë padinë e paditësit e miratoi në tërësi si të bazuar sepse pala e paditur nuk e ka kontestuar kërkesën e palës paditëse dhe i ka propozuar gjykatës që të miturat ti besohen në ruajtje dhe edukim babait të tyre sepse e njëjta nuk ka kushte për tu kujdesur për të miturat, këtyre theksimeve gjykata u'a dhe besimin dhe vendosi si në dispozitiv të këtijë aktgjykimi, si dhe konform nenit 139 par.1, 144 dhe 145 të Ligjit për Familjen i Kosovës.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata vendosi që secila palë ti përballon shpenzimet e krijuara, sepse gjatë seancës gjyqësore anjëra palë nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Ky aktgjykim është i formës së prerë që nga data 14.11.2017 sepse palët në seancën gjyqësore kanë hequr dorë nga e drejta e ankesës dhe i kanë propozuar gjykatës që vendimi të bëhet i formës së prerë.


GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-

Dega në Kaçanik

C.nr.273/17 prej dt.14.11.2017

Kryetari i trupit gjykues- Gjyqtari:

Riza Livoreka



Prisje
14. 11. 2017